

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dokument/ 34 milionë euro paradhënie për Ron Yeffetin; Pirro Vengu dhe Ermal Nufi paguan 5 fatura pa marrë asnjë pajisje
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/20/dokument-34-milione-euro-paradhenie-per-ron-yeffetin-pirro-vengu-dhe-ermal-nufi-paguan-5-fatura-pa-marre-asnje-pajisje/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 14:22:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 14:21:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8f1c9b02c84b43f28538f75a4103264200efc7b00aa058c90083d9bb99cb4456
TEKSTI	92174e165647cb24c18c425db7c85511145bc577e512f2bce09cce3701b1f5fe
PAMJA	bba3d297eb9667554fc5722078bc1e1d92d63f87199956460279dfdf695177e4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	58e15784f802be6ecb0deaa25d62df2c04ec75de3eff8112ffdf094397b35a05
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ac48a4064545432ea373f4e7d0b56014d8dcbe9272af7bcd7f9339adcddebee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/58e15784f802be6ecb0deaa25d62df2c04ec75de3eff8112ffdf094397b35a05>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Dokument/ 34 milionë euro paradhënie për Ron Yeffetin; Pirro Vengu dhe Ermal Nufi paguan 5 fatura pa marrë asnjë pajisje

Kryesore

Publikuar: 20/09/2026

f X



Ndërsa ish-ministri Besfort Lamallari, më 18 gusht, i dha 9.6 milionë euro paradhënie për blerje automjetesh për IKMT-në, të cilat izraeliti Ron Yeffet nuk i ka sjellë akoma...

Dokumentet e Thesarit zbulojnë 5 pagesa të ushtrisë për 'Timak Defence' të izraelitit Ron Yeffet, nga 10 miliardë lekë për pajisje anti-dron te automjetet taktike; të gjitha brenda 24-48 orësh nga fatura, pa asnjë dorëzim. Ndërsa kompania raporton humbje 118 milionë lekë, ish-ministri Lamallari i dha edhe 9.6 milionë euro të tjera paradhënie për IKMT-në, ndërsa makinat ende nuk kanë mbërritur.

"Pamfleti" po publikon dokumente dhe të dhëna zyrtare nga Ministria e Mbrojtjes, nga strukturat përbërëse të saj dhe nga Thesari i Shtetit, me të cilat vërtetohen aferat financiare me buxhetin e ushtrisë, në favor të mafiozit izraelit Ron Yeffet, mik dhe klient i kryeministrit Edi Rama.

Në muajin tetor 2025, kur Ministër i Mbrojtjes ishte Pirro Vengu, dhe në muajt mars, prill e qershor 2026, në drejtimin e ministrit Ermal Nufi, ushtria i ka bërë 5 pagesa me vlerë rreth 34 milionë euro me TVSH kompanisë "Timak Defence", ku Ron Yeffet dhe Arjeta Puca kanë 80% aksione, ndërsa shoqëria "Kayo" e Ministrisë së Mbrojtjes ka 20% aksione.

Me të lexuarat

- Safet Gjici u rikthehet tenderave të dyshimtë pas lirimit nga burgu, në krye të Etnë Xhatull Post... Shpërblen
- Sërish Bashkim Ulajn - Në kulmin e protestave për Rrethina, pranvera ... Pranvera Gruda përfitoi dhjetëra mijëra euro nga buxheti i Shtetit për pargat diplomatike / Lulëzim Ndreu i Univeristetit dhe Kolegjit Amerikan të Lirisë nx...
- Martinajn /Personazhi që po eliminon grupin e Canes së Sarandës me 23 emra,...

Pesë pagesat që i janë bërë Ronit të Edi Ramës:

· *Reparti Ushtarak Nr. 3001 në Rinas-Tiranë, strukturë e Forcës Ajrore të Ushtrisë, i ka paguar kompanisë “Timak Defence” vlerën 10 miliardë, 130 milionë e 650 mijë lekë të vjetra pa TVSH, për blerje mjetesh dhe pajisjesh teknike, me Kontratë nr. 1980/1, datë 13 tetor 2025, me Faturë nr. 79/2026, datë 23 qershor 2026, çuar në Thesar në datën 24 qershor 2026, bërë pagesa brenda 24 orësh, në datën 25 qershor.*

· *Përsëri Reparti Ushtarak Nr. 3001 i ka paguar kompanisë “Timak Defence” vlerën 5 miliardë e 682 milionë lekë të vjetra pa TVSH, për pajisje të sistemit anti-dron, me Kontratë Nr. 5774/2, datë 10 tetor 2025, çuar në Thesar me Faturë nr. 25, datë 24 prill 2026, bërë pagesa më 27 prill.*

Përsëri Reparti Ushtarak Nr. 3001 i ka paguar kompanisë “Timak Defence” vlerën 6 miliardë e 819 milionë lekë të vjetra pa TVSH, për blerje pajisjesh përsëri për sistemin anti-dron, me Kontratë Nr. 1980/1, datë 13 tetor 2025, me Faturë Nr. 1, datë 27 tetor 2025, çuar në Thesar në datën 28 tetor 2025 dhe likuiduar në datën 29 tetor.

· *Qendra e Furnizimit të Materialeve Teknike-Tiranë, që është strukturë logjistike e ushtrisë, i ka paguar kompanisë “Timak Defence” vlerën 110 milionë, 184 mijë e 272 lekë të vjetra pa TVSH, për blerje automjete speciale, me Kontratë Nr. 4173/1, datë 23 prill 2026, me Faturë nr. 30/2026, çuar në Thesar në datën 25 maj 2026 dhe likuiduar më 26 maj.*

Reparti Ushtarak Nr. 4300 në Vaqarr-Tiranë, që është Brigada Logjistike e Ushtrisë, i ka paguar kompanisë “Timak Defence” 4.4 miliardë lekë të vjetra pa TVSH, për blerje automjete taktike të transporteve të lehta, me Kontratë nr. 567, datë 29 tetor 2025, me Faturë nr. 2, datë 31 tetor 2025, çuar në Thesar në datën 3 nëntor 2026 dhe likuiduar në datën 4 nëntor.

Sipas informacionit të ardhur në “Pamfleti” nga burime brenda Ministrisë së Financave, prej nga varet Thesari i Shtetit, thuhet se

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, nëpërmjet strukturave në vartësi, ka bërë gati 3 fatura pagesash të tjera me vlerë rreth 13 milionë euro, për llogari të kompanisë së izraelitit Ron Yeffet.

Megjithëse kompania e tij "Timak Defence" ka marrë 34 milionë euro nga ushtria, për vitin 2025 ka raportuar bilanc me humbje 118 milionë lekë; mashtrim që ia ka miratuar dhe Ministria e Mbrojtjes, si ortakë nëpërmjet shoqërisë "Kayo", madje Kryetar Bordi ishte ministri Ermal Nufi.

Ndërsa ish-Ministri i Brendshëm, Besfort Lamallari, në datën 18 gusht 2026, i dha 9.6 milionë euro paradhënie për blerje automjete për IKMT-në, të cilat izraeliti Ron Yeffet nuk i ka çuar akoma në këtë institucion./**Pamfleti**

TAG:

30 mln euro paradhënie

5 fatura

Ermal nufi

Ron Yeffet

Të ngjashme

Ka tejkaluar edhe Vis Martinajn /Personazhi që po eliminon grupin e Canes së Sarandës me 23 emra, saga e hakmarrjes pas plagosjes së dyfishtë në 20...

Kokainë dhe targa diplomatike / Lulëzim Ndreu i Univeritetit dhe Kolegjit Amerikan të Tiranës nxjerrë jashtë loje mafien italiane në Siçili, kush ...

Vajza e prokurores Pranvera Gruda përfitoi dhjetëra mijëra euro nga buxheti i shtetit. Pastrim parash me firmat farmaceutike përmes Ample?

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.